



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	
Dep.	20/DPK
Dep.	
Nr. ifaq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
PRISHTINE	
Nr. Prot.	01-2824/14
Br.Prot.	
Prot No.	
Data	
Datum	
Date	11.08.2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 25.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllt rasti me nr. AKK-03-2171/14, për z. Bexhet Kuçi, Këshilltar komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtaue për konflikt te interesit me numër protokolli AKK-03-2171/14,qe për trajtim ka pas zyrtarin e larte z. Bexhet Kuçi, Këshilltar komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës se ushtrimit të funksionit publik si, Këshilltar komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës është duke ushtruar edhe funksione tjetra ne veprimtari private, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situate paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korruptionit me datën 07.07.2014. e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Bexhet Kuçi, Këshilltar komunal ne Kuvendin Komunal të Suharekës pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar qe ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm te interesit.

Zyrtarët e Agjencisë ne takimin qe është mbajtur me z.Kuçi me datën 14.07.2014 e kanë njoftuar me faktet qe posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit ne ushtrim te funksionit publik, ndërsa, z. Kuçi është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se ne afat sa me te shpejt do te bej ndryshimet e nevojshme dhe do te shmanget nga situata e mundshme e konfliktit te interesit.

Me datën 21.07.2014, z. Bexhet Kuçi, ka sjell ne Agjenci dokumentin zyrtar te lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohët se janë ber ndryshimet e kërkuaara dhe se ne biznesin privat me nr biznesi 80160569 dhe emër "N.T.T –Jeta"- zyrtari ne fjale ka autorizuar një person tjetër.

Vlerësojmë se zyrtari i lartë publik pas veprimeve te ndërmarra pas kërkesës se Agjencisë ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit të interesit në të cilën ndodhej

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit

